

**RAPORT PËR AUDITIMIN E RAPORTIT VJETOR FINANCIAR TË PARTISË**  
**BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT**  
Pasqyrat Financiare që i përgjigjen vitit ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2020



**Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**  
**Partisë “Bashkimi për të drejtat e njeriut”**  
**TIRANË**

**I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

**A. INFORMACION LIGJOR**

**i. Kuadri ligjor**

Kuadri ligjor referohet dhe në kontratën e shërbimit të auditimit ligjor të raporteve vjetore financiare të partive politike sipas ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar dhe procesi i realizimit të tij bazohet në, ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Përauditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, legjislacionin e fushës fiskale, si dhe në aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për këtë qëllim.

**ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme**

Në përputhje me ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, partitë politike kanë statusin e njësive jofitimprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të)

**B. OBJEKTI I AUDITIMIT**

**i. Kontrata e shërbimit**

Për përmbushjen e misionit të auditimit, me palën angazhuese KQZ-në, u lidh kontrata e shërbimit me nr. 6277 datë 23.08.2021, me objekt auditimin vjetor të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020, në përputhje me ligjin nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, ligjin nr.10019, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar si dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

**ii. Vendimi i KQZ-së**

Në përputhje me kuadrin rregullator të përzgjedhjes dhe emërimit të ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e partive politike, KQZ-ja me vendimin nr. 425 datë 12.07.2021 na ka emëruar si auditues të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.

**iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor.**

Auditimi ynë do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për financat në parti të politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë), të pranojnë dhe kuptojnë se kanë përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare (raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo fitimprurëse (SKK për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të ligjit “për Partitë Politike” i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- b) Për kontrollet e brendshme të atilla që drejtimi i partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi; dhe
- c) T’i japin audituesit:
  - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
  - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit dhe;
  - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda partisë nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit ne kërkojmë nga drejtimi i partisë kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marrim, prej tyre konfirmime me shkrim, lidhur me deklaratimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

#### **iv. Përgjegjësitë e audituesit**

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomali të materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me SNA-të.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar) në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë por, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

## C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

### i. Prezantimi i subjektit politik

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut është themeluar në shkurt të vitit 1992, vazhdimisht ka qenë e përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë dhe në të gjitha nivelet e pushtetit lokal. Ajo është parti e organizuar dhe e strukturuar si në aspektin administrativ ashtu edhe në atë politik – statutor. PBDNJ ka 33 degë në mbarë vendin dhe rreth 7800 anëtarë. Ajo përfaqëson minoritetet e Shqipërisë, kryesisht minoritetin grek, dhe është vazhdimi politik i shoqatës “Omonia”.

### ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit të partisë

Në zyrat e saj qendrore, në administratë punon vetëm sekretari. Financieri është vullnetar i jashtëm. Struktura politiko – statutore e kësaj partie përfshin:

#### Qendra

- Kryetari
- Këshilli Drejtues
- Kryesia
- Sekretarët

#### Degët

- Kryetar dege
- Këshilli
- Kryesia
- Anëtarët

## D. PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR DHE STRUKTURA E TIJ

### i. Struktura e raportit – këkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.

Struktura e raportit vjetor financiar (Pasqyrat Financiare) të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të publikuara në KQZ, përbëhen:

- Informacion për subjektin zgjedhor
- Pasqyrën e performancës (pasqyra e aktiviteteve)
- Shënime shpjeguese

### ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe cdo personi tjetër të tretë

Menjëherë pas firmosjes së kontratës me KQZ-në, në datën 23.08.2021 pas e-mailit që dërgova në adresën zyrtare të publikuar në faqen e PBDNJ-së, u kontaktova me telefon nga z. Olgert Thomollari i cili merret me çështjet administrative dhe ekonomike të partisë. Më pas u takuam dhe z. Thomollari na vendosi në dispozicion raportin vjetor financiar për vitin 2020, dokumentacionin kontabël, rregjistrimet dhe informacione të tjera që lidhen me auditimin tonë. Gjithashtu kontaktuam edhe me z. Ervin Ziko i cili merrej me përgatitjen e pasqyrave financiare. Nisur nga situata e Covid jam përbiekur

për kufizimin e takimeve sa më shumë të ishte e mundur dhe shumica e tyre është kryer online, me email, apo me mjete të tjera komunikimi virtual (telefon, ehatsapp, sms etj)

**iii. Paraqitje e përgjithshme e raportimeve vjetore të partisë politike (nëse është apo jo në përputhje me kërkesat e raportimit)**

Ne vlerësuam paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor (pasqyrave financiare), përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, të publikuara për vitin 2020 nga PBDNJ, nëse ato paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrën që të japin paraqitjen e drejtë.

Pasqyrat financiare të paraqitura dhe të publikuar në faqen e KQZ-së, nuk janë hartuar në përputhje me SKK-në për OJF-të, i cili në seksionin 25 ku përcakton se:

Pasqyrat financiare të OJF-ve përbëhen nga:

- pasqyra e pozicionit financiar,
- pasqyra e aktiviteteve, dhe
- pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

Organizatata jo fitimprurëse japin në shënimet shpjegues informacione të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve dhe shërbimeve që kryejnë.

Pra raportimit financiar të PBDNJ-së i mungon pasqyra e pozicionit financiar si dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.

**II. KËRKESAT FORMALE**

**A. PËRMBLEDHJE**

1/ Data e dorëzimit të raportit vjetor			
	Dorëzimi fizik	P o	Datë 09.03.2021
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	P o	Datë 06.03.2021
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Emër: Vangjel Dule – Kryetari i Partisë; Ervin Ziko – Drejtor Finance

**B. CAKTIMI I AUDITUESIT LIGJOR DHE LLOGARISË BANKARE**

1/ Informacioni për parti të politike	
Emri i partisë politike	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
Adresa e selisë qendrore	Bulevardi Bajram Curri, Nr 32 Tiranë
Numri i telefonit të selisë qendrore	Tel/Fax: 042377921 – +355692604461
Adresa e email-it të selisë qendrore të partisë	<a href="mailto:pbdnj.zyraeshtypit@gmail.com">pbdnj.zyraeshtypit@gmail.com</a> ; <a href="mailto:contact@pbdnj.com">contact@pbdnj.com</a> ;
2/ Informacion për audituesin ligjor	



Art-Auditing

, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,  
Kompleksi Magnet, Tiranë  
Email: [merilika@outlook.com](mailto:merilika@outlook.com)  
Tel: 069 20 24 448

Emri i audituesit ligjor të caktuar	Meri Lika
Adresa e audituesit ligjor	Rruga "Artan Lenja", Kompleksi Kontakt, Godina Orion,
Numri i telefonit të audituesit ligjor	+355 69 20 24 448
Adresa e email-it të audituesit ligjor (nëse ka)	merilika@outlook.com
<b>3/ Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike</b>	
Emri i bankës ku mbahet llogaria	Alpha Bank
Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Bulevardi Zogu I, Nr. 47, Tiranë
Numri i telefonit të zyrës së bankës	04 223 6740
Adresa e email-it të zyrës së bankës apo zyrtarit	
Numri i llogarisë bankare	AL92902112090201250000440062
Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Vangjel Dule; Olgert Thomallari

### C. AKTIVET DHE DETYRIMET

<b>1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve</b>	
Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare 31.12.2020 përbëhen: - Mjetet monetare në arkë dhe në bankë - Aktivet afatgjata materiale	
Përshkruani vendndodhjen e aktivitetit - Vendëndodhja e mjeteve monetare është në llogarinë bankare të entitetit - Vendëndodhja e aktiveve materiale është pranë selisë së partisë. - Partia nuk ka aktive në degët e saj nëpër rrethe	
Shkruani vlerën e tregut të aktivitetit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur ○ Mjetet Monetare në bankë 1,352.79 lekë	
<b>2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve</b>	
Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit Sipas llojit detyrimet në datën e mbylljes së vitit ushtrimor 31.12.2020 përbëhen: - Nuk ka detyrime	
Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet – Nuk ka detyrime	
Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve –Nuk ka detyrime	

### D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

<b>Përmbledhje Financiare</b>	
Periudha e raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raportin)	01.01.2020 – 31.12.2020
Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon raportin)	Gjendje banka 01.01.2020 = 17,434.79 leke Gjendje banka 31.12.2020 = 1,352.79 lekë
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	Të ardhura gjithësej = 850,000.00 lekë



Miratuar me Udhëzimin nr. 10 datë 21.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra.	<i>Shpenzimet gjithësej = 866,082.00 lekë</i>
Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fillimit dhe e perfundimit të periudhës që mbulon)	<i>31.12.2020</i>
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit	<i>Aktivet = 1,352.79 lekë</i>
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.	<i>Detyrimet = 0.00 lekë</i>

#### a/ Audituesi Ligjor

- Identiteti i audituesit ligjor
  - o Kush?  
Meri Lika
  - o Çështja e mospërputhjeve të mundëshme  
Bashkëngjitur raportit deklarata e pavarësisë.
- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit vjetor
  - o Nënshkrimi i raportit vjetor  
Nënshkrimi i raportit vjetor është bërë nga z. Vangjel Dule dhe z. Ervin Ziko
  - o Paraqitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: vërejtja e problemeve të dukshme (shiko më poshtë)

a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	<b>Të Ardhurat</b>		850,000
		Financime publike	
		Donacione private	850,000
		Financim nga burimet e veta të partisë	
		Hua/Kredi	
			866,082
	<b>Shpenzime</b>		
		Shpenzimet e qerasë	
		Stafi / rrogat	613,141
		Media	
		Komunikimi	
		Transporti	
		Shpenzimet bankare	6,679
		Administrative dhe të Përgjithshme	242,262
		Amortizimi	
		Menaxhimi i Pronës	
		Shpenzime të tjera	

### b/ Asetet/detyrimet dhe përmbledhjet financiare

- Çdo mospërputhje / parregullsi në lidhje me deklarinimin e aktiveve dhe detyrimeve. Gjatë auditimit të aktiveve dhe detyrimeve është vërejtur mungesave e pasqyrës së pozicionit financiar.

- Defiçit/ shpenzime të papaguara

Gjatë vitit 01.01.2020 – 31.12.2020 nuk mund të përcaktojmë detyrimet e papaguara për arsye të mospasjes së pasqyrës së pozicionit financiar.

## III. TË ARDHURAT

### A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit	Sipas auditimit të kryer
<b>1/ Financimi publik</b>			
	Shuma e granteve publike të marra	0	0
	Data e tranfertës		
<b>2/ Donacionet private</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	850.000	850.000
	Shuma e donacioneve në para	850.000	850.000
	Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
	Paraqitja e një liste të donatorëve		Erges Mullisi, Jugert Malaj, Ardjan Sulaj, Ervin Ziko, Ervin Qato, Foto
	Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare		31.01.20; 27.02.20; 29.05.20; 09.07.20; 03.08.20; 10.09.20;
	Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar		850.000
	Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarinimit bankar (data)		31.01.20; 27.02.20; 29.05.20; 09.07.20; 03.08.20; 10.09.20;
	Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarinimit bankar (donatori)		Jane depozituar nga Olgert Thomllari
	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		
	A përputhen shifrat e përgjithshme?		PO
	Respektimi i kufirit të donacionit		PO
<b>3/ Financimi nga burimet e vetë partisë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	Nuk ka	Nuk ka
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	Nuk ka	Nuk ka
	Kuotat e anëtarësisë	Nuk ka	Nuk ka
	Botimet	Nuk ka	Nuk ka
	Shtypshkronja	Nuk ka	Nuk ka
	Dhënia me qera	Nuk ka	Nuk ka
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	Nuk ka	Nuk ka



	Kuotat e anëtarësisë	Nuk ka	Nuk ka
	Botimet	Nuk ka	Nuk ka
	Shtypshkronja	Nuk ka	Nuk ka
	Dhënia me qera	Nuk ka	Nuk ka
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar	Nuk ka	Nuk ka
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar		Nuk ka
<b>4/ Huatë/Kreditë</b>			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	Nuk ka	Nuk ka
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	Nuk ka	Nuk ka
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	Nuk ka	Nuk ka
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi /	Nuk ka	Nuk ka
<b>5/ Marrja e të ardhurave</b>			
	Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë përkatëse.	Po	Donacionet janë arkëtuar në arkë dhe po brenda ditës janë depozituar në bankë nga Olgert Thomollari

#### Kontributet e Specifikuara

Kriteret e kontributeve	
Emri i kontribuesit	Nuk ka
Adresa e kontribuesit	Nuk ka
Profesioni i kontribuesit (nëse kontribuesit nuk ka profesion, shkruani "nuk ka profesion")	
Përshkrimi i kontributit (i tillë si "para në dorë" apo "çek" apo "transfertë bankare" apo "përshkrimi i kontributit në natyrë")	Nuk ka
Vlera e kontributit (për kontributet në natyrë shkruani vlerën e tregut, që është vlera e sendit nëse shitet në atë gjendje aktuale)	Nuk ka
Data kur është marrë kontributi	Nuk ka

## B. ANALIZA

### a/ Financimi nga burimet jo publike

#### - Donatorët e lejuar:

- o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar; Neni 21 i Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000, ndryshuar më Ligjin Nr. 10374, datë 10.02.2011, Ligjin Nr. 17/2014, datë 20.02.2014, Ligjin Nr. 25/2014, datë 25.09.2014, përcakton se "Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e

juridikë privat vendas” sikurse Neni 23/1 (ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.02.2011) vë në dukje se:

1. Çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.

2. Dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, duhet të bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga partia politike. Personi përgjegjës për financat në parti politike, brenda tre muajve nga krijimi i partisë politike, deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim. Numri i llogarisë bankare për çdo subjekt politik publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.

Këtyre kërkesave ligjore PBDNJ i është përmbajtur dhe i ka respektuar në mënyrë rigorozë.

- o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;

Donacionet janë nëntë nga tetë persona të ndryshëm në nivel qendror.

- o Të paraqitet një listë e të gjithë donatorëve shuma e përgjithshme e të cilëve është më e madhe se 100,000 Lekë në raportin vjetor, së bashku me shumën e përgjithshme të dhuruar;

Donatorët janë:

DONATORI	NR ID	SHUMA
JUGERT MALAJ	I503120170	150.000
FOTO GJOTI	I30624111J	200.000
ERVIN ZIKO	I4030410H	118.000

- o Të paraqitet shuma e donacioneve që kanë vlerën më pak se 100.000 Lekë, dhe shuma totale e këtyre donacioneve;

Donacionet që e kanë vlerën më pak se 100.000 lekë janë 382.000 lekë dhe janë 1 donacion 73.000 lekë, 3 donacione 75.000 lekë dhe një donacion 84.000 lekë.

- **Burimet e palejuara**
- **Kontributet në natyrë**
  - o Vlerësimi:

Nuk ka kontribute në natyrë

- ❖ Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) financimit dhe veprimtarisë vullnetare
- ❖ Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave / shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë) → kur partisë i ofrohen mallra apo shërbime falas në një çmim që është 10% më i ulët se çmimi i tregut, dallimi mes çmimit të tregut dhe pagesës së paguar nga partia duhet të pasqyrohet si donacion (së bashku me emrat e donatorëve nëse ky dallim e kalon shumën 100,000 Lekë).
- ❖ Çmimi i tregut të mallrave dhe shërbimeve duhet të përcaktohet nga referenca e indeksit të çmimeve mujore të botuar nga INSTAT në kohën kur janë dhënë/ofruar mallrat/shërbimet. Në rast se indeksi nuk përfshin mallrat/shërbimet e ofruara, partia politike duhet të llogarisë çmimin e tregut duke u bazuar në mesataren e çmimeve të tre ofruesve të ndryshëm të mallrave/shërbimeve në kohën kur ato janë ofruar.

o **Kufizimet**

- ❖ Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
- ❖ Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë).

**b/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike**

- **Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
  - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe ndarja e shumave të marra = 0 lekë
  - o Botimet = 0 lekë
  - o Shtypshkronjat = 0 lekë
  - o Marrja me qera..... = 0 lekë

- **Klasifikimi në bazë të emrit të degës i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar**
  - o Zyra Qendrore = 0 lekë
  - o Degët lokale = 0 lekë
- **Përputhshmëria mes natyrës së të ardhurave dhe shumës së deklaruar dhe deklarimit bankar**

Të ardhurat e raportuara në pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2020 janë plotësisht të përputhura me natyrën e tyre, me raportimin financiar vjetor të hartuar nga PBDNJ dhe me deklarimet bankare.

#### **c/ Huatë/Kreditë**

- Identiteti i huadhënësit/ve *Nuk ka*
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë). *Nuk ka*
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë/huasë/ve (*problemi i huave të fshira – në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*) *Nuk ka*
- Normat e interesit *Nuk ka*

**IV. SHPENZIMET**
**A. PËRMBLEDHJE**

Shpenzimet e bëra nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet e deklaruar në raportin	Fatura te paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumetet mbështetëse që	Shpenzimet të papaguar	Mospërputhje në lidhje me dokumentat	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zjedhore
Shpenzimet e qerasë							
-Qiramarrja e ambienteve							
- Shërbimet komunale:	12.8550	12.8550	12.8550	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	12.8550
-energjia	190.685	190.685	190.685				190.685
Stafi/ rrogat	613.141	613.141	613.141	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	613.141
Media	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Komunikimet	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
- Botimet	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
- Materialet promovuese	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
-Sondazhet e opinionit publik/Konsulenca	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Transporti	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Automjetet me qera dhe karburanti	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Akomodimi	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	0
Vaktet dhe shpenzime të paparashikuara							
Shpenzimet bankare	6.679	6.679	6.679	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	6.679
Administrative dhe të përgjithshme	242.262	242.262	242.262	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	242.262
Amortizim	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Menaxhim i Pronës	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Shpenzime të tjera	0	0	0	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	



Art-Auditing

, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,  
Kompleksi Magnet, Tiranë  
Email: [merilika@outlook.com](mailto:merilika@outlook.com)  
Tel: 069 20 24 448

Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet e deklaruara në raportin vjetor	Faturat e paraqitur	Faturat e Përgjithshme	Dokumentet mbështetëse	Shpenzimet të papaguar	Mospëruar në lidhje me dokumentet	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Shpenzimet e gerasë							
-Qiramarrja e ambienteve - Shërbimet komunale: -energja - uji - telefoni							
Stafi/ rrogat							
Media							
Komunikimet							
1- Botimet							
2 Materialet promovuese							
Transporti							
1- Automjetet me qera dhe karburanti							
2- Akomodimi							
Shpenzimet bankare							
Administrative dhe të përgjithshme							
Amortizim							
Menaxhim i Pronës							
Shpenzime të tjera							



Miraturar me Udhëzimin nr. 10 datë 21.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Të gjitha shpenzimet e kryera të paguara përmes një llogarie të veçantë

Nuk ka

## A. ANALIZA

a/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë:

Nuk ka të dhëna për shpenzime të bëra nga degët e partisë në rrethe.

- **Shpenzimet e qiramarrjes**
  - ▣ Marrja me qera e ambienteve
  - ▣ Shërbimet komunale (energji, uji, telefoni)
- **Stafi/ rrogat**
- **Media**
- **Komunikimi**
  - ▣ Botime
  - ▣ Materiale promovuese
  - ▣ Sondazhe të opinionit publik / konsulenca
- **Transporti**
  - ▣ Marrja me qera e automjeteve dhe karburanti
  - ▣ Akomodimi
  - ▣ Vaktet dhe shpenzimet e paparashikuara
- **Shpenzimet bankare**
- **Administrative dhe të përgjithshme**
- **Amortizimi**
- **Menaxhimi i pronës**
- **Shpenzime të tjera**

## b/ Verifikimi

- Rrisqet
  - Rrisqet kryesore të auditimit në lidhje me shpenzimet e partisë janë se:
    - Shpenzimet deklarohen më të ulëta  
Shpenzimet deklarohen me dokumente të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Taksave dhe jo më të ulëta.
    - Shpenzimet nuk shoqërohen nga një faturë e vërtetë
- Çdo shpenzim i kryer shoqërohet nga një faturë e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Taksave
- Informacioni për shpenzimet e partisë përfshin jo vetëm aktivitetet e përditshme të partisë por gjithashtu edhe shpenzimet që kanë të bëjnë me një fushatë zgjedhore në vitet zgjedhore.

Gjatë periudhës ushtrimore 01.01.2020 – 31.12.2020 nuk ka patur asnjë fushatë zgjedhore gjë e cila bën që pasqyrat financiare të hartuara për këtë periudhë nga PBDNJ-ja të përfshijnë vetëm aktivitetin e përditshëm të saj.

Në mënyrë që të dokumentohen mirë financat e partisë politike nevojitet përdorimi i metodave standarde të auditimit. Në kontekstin e financave të partisë politike, metodat e mëposhtme janë shembuj i hartimit të metodave të tilla për specifikat e financave të partive politike:

- Shqyrtoni një kategori të deklaruar të përzgjedhur të pagesave (për shembull për komunikimet) të krahasuar me dokumentacionin mbështetës/evidencat (faturat);

PBDNJ ka dokumentuar, regjistruar dhe evidentuar çdo veprim kontabël. Ne si auditues në zbatim të Standardeve të Auditimit kemi marrë në shqyrtim llogarinë e Albtelekom të cilën po e paraqesim si më poshtë.

Gjatë shqyrtimit me përzgjedhje të pagesave për komunikim u vërejt se: shih tabelën përkatëse.

Ref	Data	Lloji I dokumentit	Përshkrimi I veprimit	Regjistrimi	Vlera
728692310	01-01-20	Fature blerje	Sherbim Dhjetor 2020	Debi llog 626 Shpenzime komunikacioni	1920
728692310	01-01-20	Fature blerje	Sherbim Dhjetor 2020	Kredi llogaria 401 Furnitoret	1920
81	31-01-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Debi llog 401 Furnitoret	1920
81	31-01-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Kredi llog 531 Arka	1920
728842331	28-02-20	Fature blerje	Sherbimi Janar 2020	Debi llog 626 Shpenzime komunikacioni	1976
728842331	28-02-20	Fature blerje	Sherbimi Janar 2020	Kredi llogaria 401 Furnitoret	1976
32	02-03-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Debi llog 401 Furnitoret	1976
32	02-03-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Kredi llog 531 Arka	1976
729157035	30-04-20	Fature blerje	Sherbimi Mars 2020	Debi llog 626 Shpenzime komunikacioni	1920
729157035	30-04-20	Fature blerje	Sherbimi Mars 2020	Kredi llogaria 401 Furnitoret	1920
729033460	28-02-20	Fature blerje	Sherbimi Shkurt 2020	Debi llog 626 Shpenzime komunikacioni	1920
729033460	28-02-20	Fature blerje	Sherbimi Shkurt 2020	Kredi llogaria 401 Furnitoret	1920
100	29-05-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Debi llog 401 Furnitoret	1920
100	29-05-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Kredi llog 531 Arka	1920
110	29-05-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Debi llog 401 Furnitoret	1920
110	29-05-20	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Kredi llog 531 Arka	1920
729488203	31-05-20	Fature blerje	Sherbimi Maj 2020	Debi llog 626 Shpenzime komunikacioni	124
729488203	31-05-20	Fature blerje	Sherbimi Maj 2020	Kredi llogaria 401 Furnitoret	124
2.00803E+17	03-08-20	Pagese EasyPay	Likujdim sherbimi Albtelekom	Debi llog 401 Furnitoret	124
2.00803E+17	03-08-20	Pagese EasyPay	Likujdim sherbimi Albtelekom	Kredi llog 531 Arka	124
729309437	30-06-20	Fature blerje	Sherbimi Prill 2020	Debi llog 626 Shpenzime komunikacioni	1760
729309437	30-06-20	Fature blerje	Sherbimi Prill 2020	Kredi llogaria 401 Furnitoret	1760
37	13-07-21	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Debi llog 401 Furnitoret	1760
37	13-07-21	Kupon tatimor	Likujdim sherbimi Albtelekom	Kredi llog 531 Arka	1760



- Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ketë një përputhje me donacionet në natyrë.

Gjatë vitit 2020 PBDNJ nuk ka bërë shpenzime në natyrë.

## V. PËRFUNDIMI

### A. SINTEZA

#### a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.

Pasqyra e performancës dhe shënimet shpejguese bashkëngjitur janë përgatitur bazuar në SKK për oJF-të i shpallur nga Ministria e Financave me Urdhër Nr. 62 datë 17.05.2016.

Por këto pasqyra nuk e realizojnë objektivin e pasqyrave financiare për dhënien e një informacioni rreth pozicionit financiar si dhe për fluksin e mjeteve monetare për shkak se këto dy pasqyra nuk janë të përfshira si pjesë integrale e raportimit financiar për vitin ushtrimor 2020.

Pasqyra e performancës jep një pamje të drejtë rreth evidencës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Të dhënat e periudhave të mëparshme janë të krahasueshme me të dhënat e periudhës së vitit ushtrimor 2020.

Për vitin 2020 PBDNJ nuk ka bërë vlerësimë kontabël me ndikim material.

Partia "Bashkimi për të drejtat e njeriut" nuk ka kontribute të marra në natyrë. Ajo ka 8 donacione nga persona fizikë shtetas shqipëtar në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr 10019 datë 29.12.2008 i ndryshuar "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" si dhe të Ligjit Nr 8580 datë 17.02.2000 i ndryshuar "Për partitë politike".

Të ardhurat janë dokumentuar dhe regjistruar sipas rregullave kontabël. Në të ardhurat janë përfshirë donacionet.

Në shpenzime janë përfshirë të gjitha shpenzimet e bëra gjatë vitit ushtrimor 2020 të cilat janë dokumentuar, evidentuar dhe regjistruar saktë sipas rregullave kontabël në fuqi.

#### b. Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit.

Gjatë procesit të auditimit ne kemi gjetur disa paregullsi:

1. Formati i raportimit financiar nuk është në përputhje me me ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht me Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të) seksioni 25, sepse mungojnë pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.
2. Gjatë aktivitetit financiar të PBDNJ-së nuk është zbatuar e legjislacionit tatimor, Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 20 për "Shpenzimet e njohura" si dhe neni 21 pika "n" për "shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar".

## B. PËRFUNDIMI

- o Çertifikimi me përmirësime / rezerva

Të nderuar zotërinjë,

Ne kemi audituar fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga partia “ Bashkimi për të drejtat e njeriut”, për vitin 2020 të raportuara prej saj sipas kërkesave të ligjit nr 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar, dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij në lidhje me fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga partia politike gjatë vitit kalendarik pararendës, të hartuara në përputhje me ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht me Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të) dhe të publikuara në faqen e KQZ-së , që përmbajnë:

1. Informacion për subjektin zgjedhor
2. Pasqyrën e performancës
3. Shënimet shpjeguese

Sipas opinionit tonë, raporti financiar bashkëlidhur paraqet drejt në të gjitha aspektet materiale vetwm fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partia politike “Bashkimi për të drejtat e njeriut”, për vitin ushtrimor 2020.

- a) Sipas opinionit tonë formati i raportimit financiar nuk është në përputhje me me ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht me Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-të) seksioni 25 ku përcaktohet se: Pasqyrat financiare të OJF-ve përbëhen nga:
  - pasqyra e pozicionit financiar,
  - pasqyra e aktiviteteve, dhe
  - pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.Organizatave jo fitimprurëse japin në shënimet shpjegues informacione të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve dhe shërbimeve që kryejnë.

Opinionin ynë **është** modifikuar për këtë çështje.

- b) Sipas opinionit tonë subjekti partia “Bashkimi për të drejtat e njeriut” nuk ka zbatuar legjislacionin tatimor, Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 20 për “Shpenzimet e njohura” si dhe neni 21 pika “n” për “shpenzimet për paga shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar”.

Opinionin ynë **është** modifikuar për këtë çështje



**Art-Auditing**

, për të ndërtuar besimin!

Rruga Artan Lenja,  
Kompleksi Magnet, Tiranë  
Email: [merilika@outlook.com](mailto:merilika@outlook.com)  
Tel: 069 20 24 448

Tiranë më 23 shtator 2021

Audit Ligjor

Meri Lika



Miratur me Udhëzimin nr. 10 datë 21.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve